

Tax Alert Albania

October - November 2023



PwC Albania - Tax Alert

Law no. 47/2023 "On some additions and changes in the law no. 15/2019, "For promoting employment"

The Youth Guarantee scheme is part of the employment programs supporting the youth **under the age of 29**, who are unemployed, not studying or professionally training, by providing them an offer of employment/education/apprenticeship within a period of four months from the registration moment at the employment office.

Within the framework of employment of persons from special groups, each employer must employ **one person with disabilities**, including deaf persons and disabled persons partially capable of work for the **first 25 employees of the enterprise**, and **one additional person from these groups, for every 50 additional employees**. The employer, who does not comply with this obligation, pays a contribution to the account of the Social Employment Fund in the amount of **100% of the national minimum wage for each month** for each person he should have employed according to this obligation.

Source: Official Gazette no. 105, dated 13.07.2023 ([Link](#))

Decision no. 453, dated 26.7.2023 For some changes in decision no. 17, dated 16.1.2019, of the Council of Ministers, "On the determination of other state or private companies, important for the public interest, due to the nature of their business, size or number of employees"

State or private companies important for the public interest, defined as large economic entities, according to the legislation on accounting and financial statements, are classified by size, as:

- Companies, whose total value of income from economic activity (turnover) in that accounting period is equal to or greater than 2 500 000 000 ALL (up from 1 500 000 000 ALL which was before);
- Companies, whose total balance sheet assets value at the end of the accounting period is equal to or greater than 1 250 000 000 ALL (up from 750 000 000 ALL that was before).

Source: Official Gazette no. 112, dated 28.07.2023 ([Link](#))

Order no. 177, dated 2.8.2023: For the approval of the translation into Albanian of the changes in the International Accounting Standard (IAS) 12 - "Income Tax"

Changes to the International Accounting Standard (IAS) 12 "Income Tax" are announced. This Standard applies to income taxes arising from the tax legislation adopted or nearly adopted to implement the model Pillar Two rules published by the Organization for Economic Co-operation and Development (OECD). The economic entity will not recognize and will not provide explanatory information on deferred tax assets and liabilities related to the legislation of the Second Pillar, as an exception to the requirements of this Standard.

Source: Official Gazette no. 124, dated 21.08.2023 ([Link](#))

Ligj nr. 47/2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"

Skema e garancisë rinore është pjesë e programeve të punësimit që mbështet të rinjtë me moshë **nën 29 vjeç që nuk janë në punësim, arsim ose formim profesional**, duke u ofruar një ofertë punësimi/ arsimimi të vazhdueshëm/ praktika profesionale brenda një periudhe prej katër muajsh nga momenti i regjistrimit në zyrën e punësimit.

Në kuadër të punësimit të personave nga grupet e veçanta, çdo punëdhënës duhet të punësojë **një person me aftësi të kufizuara**, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët pjesërisht të aftë për punë **për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes**, dhe nga **një person shtesë nga këto grupe, për çdo 50 punonjës të tjerë**. Punëdhënësi, i cili nuk e zbaton këtë detyrim, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit në masën **100 % të pagës minimale në shkallë vendi për çdo muaj**, për çdo person që ai duhet të kishte punësuar sipas këtij detyrimi.

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 105, dt.13.07.2023 ([Link](#))

Vendim nr. 453, datë 26.7.2023 Për disa ndryshime në vendimin nr. 17, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre"

Shoqëritë shtetërore ose private të rëndësishme për interesin e publikut, të përcaktuara si njësi ekonomike të mëdha, sipas legjislacionit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, klasifikohen për nga madhësia, si:

- Shoqëri që vlerën e totalit të të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël e kanë të barabartë ose më të madhe se 2 500 000 000 lekë (nga 1 500 000 000 lekë që ishte më parë);
- Shoqëri që vlerën e totalit të aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël e kanë të barabartë ose më të madhe se 1 250 000 000 lekë (nga 750 000 000 lekë që ishte më parë).

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 112, dt.28.07.2023 ([Link](#))

Urdhër nr. 177, datë 2.8.2023: Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 12 - "Tatimi mbi të Ardhurat"

Shpallen ndryshimet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 12 "Tatimi mbi të ardhurat". Ky Standard zbatohet për tatimet mbi të ardhurat që rrjedhin nga legjislacioni tatimor i miratuar ose pothuajse i miratuar për zbatimin e modelit të rregullave të Shtyllës së Dytë të publikuar nga Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD). Njësia ekonomike nuk do të njohë dhe nuk do të japë informacion shpjegues mbi aktivet dhe detyrimet për tatime të shtyra të lidhura me legjislacionin e Shtyllës së Dytë, si përjashtim nga kërkesat e këtij Standardi.

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 124, dt. 21.08.2023 ([Link](#))

PwC Albania - Tax Alert

Law no. 73/2023 "On the ratification of the agreement between the Council of Ministers of the Republic of Albania and the Government of the Republic of Slovakia on the elimination of the double taxation in relation to income taxes and the prevention and avoidance of tax evasion".

The agreement between the Council of Ministers of the Republic of Albania and the government of the Republic of Slovakia on the elimination of the double taxation, in relation to income taxes and the prevention and avoidance of tax evasion ("DTT") is ratified. The provisions of this Agreement have effect in both Contracting States from January 1, 2024.

Source: Official Gazette no. 144, dated 05.10.2023 ([Link](#))

Law no. 70/2023 "On the ratification of the agreement between the Republic of Albania and Montenegro on social security"

The agreement between the Republic of Albania and Montenegro on social security, approved on 14.9.2023, is ratified.

This Agreement shall apply in relation to the legislation governing old-age, invalidity and family pensions, sickness cash benefits for employed persons, maternity cash benefits, work accident benefits and unemployment cash benefits.

Source: Official Gazette no. 146, dated 10.10.2023 ([Link](#))

Law no. 76/2023 "On private pension funds"

This law partially approximates directive (EU) 2016/2341 of the European Parliament and the Council, dated December 14, 2016, "On the activities and supervision of occupational pension institutions (IORP II)".

The purpose of the law is to draft a regulatory legal framework for the creation, licensing, administration and supervision of private pension funds in the Republic of Albania.

The law enters into force 15 days after its publication in the Official Gazette.

Source: Official Gazette no. 152, dated 20.10.2023 ([Link](#))

Ligj nr. 73/2023 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Sllovakisë për eliminimin e tatimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin dhe shmangien e evazionit tatimor".

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Sllovakisë për eliminimin e tatimit të dyfishtë, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe parandalimin dhe shmangien e evazionit tatimor ("DTT"). Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje kanë efekt në të dyja Shtetet Kontraktuese nga 1 janari i vitit 2024.

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 144 dt. 05.10.2023 ([Link](#))

Ligj nr. 70/2023 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi për sigurimet shoqërore"

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Malit të Zi për sigurimet shoqërore, miratuar në datën 14.9.2023.

Kjo Marrëveshje do të zbatohet lidhur me legjislacionet që rregullojnë pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare, përfitimet e sëmundjeve në para për personat e punësuar, përfitimet e barrëindjes në para, përfitimet lidhur me aksidentet në punë dhe përfitimet në para në lidhje me papunësinë.

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 146, dt.10.10.2023 ([Link](#))

Ligj nr. 76/2023 "Për fondet e pensionit privat"

Ky ligj përaftron pjesërisht direktivën (BE) 2016/2341 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 14 dhjetor 2016, "Për veprimtaritë dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pensionit profesional (IORP II)".

Ligji ka për qëllim hartimin e një kuadri ligjor rregullator për krijimin, licensimin, administrimin dhe mbikëqyrjen e fondeve të pensionit privat në Republikën e Shqipërisë.

Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 152, dt.20.10.2023 ([Link](#))

PwC Albania - Tax Alert

Order of the Minister of Finance and Economy no.232, dated 5.10.2023: For the approval of the translation into Albanian of the changes in the International Accounting Standard "Effects of changes in exchange rates (IAS 21)"

Changes to the International Accounting Standard "Effects of Changes in Exchange Rates (IAS 21)", published in August 2023, are announced, which have an effective date of January 1, 2025, but their earlier implementation is allowed.

Source: Official Gazette no. 159, dated 03.11.2023 ([Link](#))

Order of the Minister of Finance and Economy no.232/1, dated 5.10.2023: For the approval of the translation into Albanian of the changes in the International Financial Reporting Standard "Adoption for the first time of the International Financial Reporting Standards (IFRS 1)"

Amendments to IFRS 1 "First-time Adoption of International Financial Reporting Standards", published in August 2023, are applied by the entity at the same time as it applies the amendments to IAS 21.

Source: Official Gazette no.159, dated 03.11.2023 ([Link](#))

Order of the Minister of Finance and Economy no.233, dated 5.10.2023: For the approval of the translation into Albanian of the changes in the International Accounting Standard "Statement of cash flows (IAS 7)"

The changes in the International Accounting Standard "Statement of Cash Flows (IAS 7)", published in May 2023 (with an effective date of January 1, 2024), are announced, but their earlier implementation is allowed.

Source: Official Gazette no.159, dated 03.11.2023 ([Link](#))

Order of the Minister of Finance and Economy no.233/1, dated 5.10.2023: For the approval of the Albanian translation of the amendments to the International Financial Reporting Standard "Financial instruments: Disclosure (IFRS 7)"

The amendments to IFRS 7 "Financial instruments: Disclosures", published in May 2023, are applied by the entity at the same time as when it applies the amendments to IAS 7.

Source: Official Gazette no.159, dated 03.11.2023 ([Link](#))

Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.232, datë 5.10.2023: Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit "Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit (SNK 21)"

Shpallen ndryshimet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit "Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit (SNK 21)", të publikuara në gusht 2023, të cilat kanë datë efektive 1 janar 2025, por lejohet zbatimi i mëhershëm i tyre.

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 159 dt. 03.11.2023 ([Link](#))

Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 232/1, datë 5.10.2023: Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar "Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF 1)"

Ndryshimet e SNRF 1 "Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar", të publikuara në gusht 2023, zbatohen nga njësia ekonomike në të njëjtën kohë kur zbaton ndryshimet e SNK 21.

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 159 dt. 03.11.2023 ([Link](#))

Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.233, datë 5.10.2023: Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit "Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare (SNK 7)"

Shpallen ndryshimet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit "Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare (SNK 7)", të publikuara në maj 2023 (me datë efektive 1 janar 2024), por lejohet zbatimi i mëhershëm i tyre.

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 159 dt. 03.11.2023 ([Link](#))

Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.233/1, datë 5.10.2023: Për miratimin e përkthimit në gjuhën shqipe të ndryshimeve në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar "Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese (SNRF 7)"

Ndryshimet e SNRF 7 "Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese", të publikuara në maj 2023, zbatohen nga njësia ekonomike në të njëjtën kohë kur kjo e fundit zbaton ndryshimet e SNK 7.

Burimi: Fletorja Zyrtare nr. 159 dt. 03.11.2023 ([Link](#))

PwC Albania - Tax Alert

Draft laws (Bills) under discussion:

- Draft law "On real estate tax" (public consultation is closed);
- Draft decision on the analytical list of services, including professional ones, provided by self-employed natural persons and entities (not officially published).

Projektligje në diskutim:

- Projektligji "Për taksën mbi pasurinë e paluajtshme" (konsultimi publik i mbyllur);
- Projektvendimin për listën analitike të shërbimeve, përfshirë ato profesionale, të ofruara nga personat fizikë të vetëpunësuar dhe entitetet (ende pa publikuar zyrtarisht).

2024 Fiscal package

As part of the legal changes that are published every year, known as the Fiscal Package, that serves to set and administer taxes and duties, several draft laws have been published on the website of the Parliament of Albania, as follows:

- Draft law 'On some additions and changes to Law No. 92/2014, "On value added tax in the Republic of Albania", as amended';
- Draft law 'On an amendment to Law No. 61/2012, "On excise duties in the Republic of Albania", as amended';
- Draft law 'On some changes and additions to Law No. 9920, dated 19.5.2008, "On tax procedures in the Republic of Albania", as amended';
- Draft Law "On Income Tax";
- Draft law 'On an addition to law No. 10383, dated 24.2.2011, "On compulsory health care insurance in the Republic of Albania", as amended'.

These draft laws are subject to continuous changes, until their publication. For details on the changes that these legal acts are expected to implement, you can refer to the source below.

Source: The Parliament of the Republic of Albania ([Link](#))

Paketa fiskale 2024

Në kuader të ndryshimeve ligjore që publikohen çdo vit, si pjesë e Paketës fiskale që shërben për të vendosur dhe administruar tatimet dhe taksat, janë publikuar në faqen web të Kuvendit të Shqipërisë disa projektligje, si më poshtë:

- Projektligj 'Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar';
- Projektligj 'Për një ndryshim në Ligjin Nr.61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar';
- Projektligj 'Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar';
- Projektligj "Për Tatimin mbi të Ardhurat";
- Projektligj 'Për një shtesë në ligjin Nr.10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar'.

Këto projektligje janë subjekt i ndryshimeve të vazhdueshme, deri në publikimin e tyre. Për detaje mbi ndryshimet që parashikohet të sjellin këto akte ligjore, mund t'i referoheni burimit më poshtë.

Burimi: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ([Link](#))



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

